

Vendim nr. 257 datë 21.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 21.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 16 (M) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **MAKSIM ZORAQI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-780, datë 13.05.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 21, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 291 e vijues, 407, pikat 1 dhe 4, 410 dhe 415 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*); nenet 143, 150 dhe 200 të Kodit Penal (*KP*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1.Kërkuesi ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*Prokuroria e Tiranës*), ndaj shtetasit F.D. Për këtë arsye, Prokuroria e Tiranës ka

regjistruar procedimin penal të vitit 2018 ndaj shtetasit F.D., duke e akuzuar atë për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143, paragrafi i parë, i KP-së. Sipas Prokurorisë së Tiranës, shtetasi F.D. me anë të gënjeshtres ka arritur të hedhë në dorë të drejtat pasurore, banesën, në dëm të kërkuarit, të cilit nuk i ka paguar lekët sipas marrëveshjes.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 441, datë 19.02.2020, ka vendosur deklarin e të pandehurit të pafajshëm. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim Prokuroria e Tiranës.

3. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 1412, datë 06.06.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 441, datë 19.02.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndaj këtij vendimi kanë paraqitur rekurs kërkuar dhe Prokuroria e Tiranës.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-780, datë 13.05.2025, ka vendosur mospranimin e rekurseve, për shkak se nuk përmbanin shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 432 të KPP-së.

5. Në datën 05.08.2025 kërkuar i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 28.08.2025.

II

Pretendimet e kërkuarit

6. **Kërkuar**, më mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se:

6.1. I akuzuari ka kërkuar të procedohej me gjykim të shkurtuar, por nuk ka paraqitur asnjë pretendim për provat dhe faktet ose për vlefshmërinë e akteve të gjykimit. I pandehuri ka pranuar shkatërrimin e pronës së kërkuarit, por organi i akuzës nuk ka hetuar. I pandehuri ka paraqitur disa prova në prokurori dhe si për çudi ato prova u paraqitën për gjykim. Pra, i pandehuri bën edhe prokurorin. Është fshehur krimi dhe banda kriminale e cila ka mashtruar dhe vjedhur pronën e kërkuarit me anë të mashtrimit.

6.2. Gjyqtarët kanë shkruar nga 15 faqe vendime dhe nuk flasim për ligjin, por për antiligjin. Interpretimi i prokurorit pranë gjykatës së apelit është shumë i saktë, por gjyqtarët e korruptuar e refuzuan rekursin e kërkuarit. Gjykatat në vendimet e tyre nuk kanë përmendur provat e thëna nga i pandehuri. Nga organi i akuzës nuk është bërë asnjë hetim. Prona është vjedhur me anë të mashtrimit. I pandehuri nuk ka asnjë dokument për të provuar pronësinë. Gjykata duhet të marrë në konsideratë interpretimin e bërë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e cila, referuar provave dhe fakteve, vërteton saktë kryerjen e veprës

penale nga i pandehuri. I pandehuri i ka legalizuar pronën në kundërshtim me ligjin. Për këtë arsye, legalizimi duhet të deklarohet i pavlefshëm, pasi ai është bërë mbi një pronë të vjedhur me anë të mashtrimit.

- 6.3. I pandehuri pasi grabiti pronën me mashtrim e ka shkatërruar atë, duke ndërtuar një objekt tjetër, në kundërshtim me ligjin, si dhe duke e kaluar në procedura legalizimi. Në këtë rast kemi të bëjmë me një vjedhje të organizuar nga tre institucione shtetërore, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë së Tiranës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Komisariati i Policisë nr. 3, të cilët kanë marrë në mbrojtje grabitësin e pronës, pra të pandehurin.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkesës

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuenin. Në këtë drejtim, Kolegji evidenton se mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

9. Në kuptim të sa më sipër, në vlerësimin paraprak të respektimit të kriterëve të legjitimitetit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, në drejtim të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi në mbështetje të ankimit kushtetues individual, Kolegji vëren se në thelb, ai ka argumentuar se i është vjedhur prona nga i pandehuri dhe ky i fundit nuk ka asnjë dokument për vërtetimin e pronësisë; i pandehuri ka pranuar shkatërrimin e pronës, por organi i akuzës nuk ka hetuar; gjykata duhet të marrë në konsideratë interpretimin e bërë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e cila, referuar provave dhe fakteve, vërteton saktë kryerjen e veprës penale nga i pandehuri; i pandehuri e ka legalizuar pronën në kundërshtim me ligjin, për këtë arsye legalizimi duhet të deklarohet i pavlefshëm.

10. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar vazhdimisht se vlerësimi provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e Gjykatës është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete, si dhe të vlerësimit të provave dhe fakteve që kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor, nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Nga sa më lart, referuar pretendimeve të kërkuesit, Kolegji konstaton se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështjen e vlerësimit të provave, në drejtim të (pa)fajësisë të të pandehurit, për të cilin ai ka paraqitur kallëzimin penal, si dhe për procedurën e legalizimit të ndjekur nga i pandehuri dhe institucionet përkatëse, për pronën objekt mosmarrëveshjeje, të cilat nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Kërkuesi nuk ka sjellë asnjë argument konkret kushtetues për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor. Në kushtet që kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë cenimin e të drejtave kushtetuese për shkak të mënyrës sesi kanë vepruar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në zgjidhjen e çështjes konkrete, këto pretendime të tij mbeten me natyrë të pastër ligjore, ndaj nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues dhe nuk mund të merren në shqyrtim.

12. Në këtë këndvështrim, Kolegji vëren se kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përfshirë Gjykatën e Lartë, të cilat as nuk kanë tejkaluar funksionet kushtetuese dhe as nuk kanë interpretuar ligjin në mënyrë arbitrare. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* për pretendimet e paraqitura në ankimin kushtetues individual.

13. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.